



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.752/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.12.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Shendelli” shpk nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-32210-07-31-2019, me objekt “*Rikonstruksion i Zyrave Ekzistuese*”, me fond limit 14'204'935 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 30.09.2019 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime sha Durrës.

Ankimues: “Shendelli” shpk
Lagjia “Kastriot”, Rr. “Andon Profka”, “2 Kullat”, Fier

Autoriteti Kontraktor: Ujësjetllës Kanalizime sha Durrës
Lagjia nr. 17 Rruga “Dalip Peza“, Durrës

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e*

rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 31.07.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-32210-07-31-2019, me objekt “*Rikonstruktion i Zyrave Ekzistuese*”, me fond limit 14'204'935 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 30.09.2019 nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime sha Durrës.

II.2. Në datën 30.09.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 09.10.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Elda VI pa ofertë I skualifikuar
- Leon Konstruktion 11,776,298.63 I skualifikuar

- Shendelli 13,000,000 I skualifikuar
- Ina 13,867,450 I kualifikuar

II.4. Në datën 09.10.2019 operatori ekonomik “Shendelli” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

2. *Operatori Ekonomik “SHENDELLI” shpk është skualifikuar për arsye se nuk përmbush:*

- *Pika 4.1 Nuk ka paraqitur dokumenta per topograf*
- *Pika 4.4 Bojaxhi Edmond Karaj nuk perkon nr i serise se deshmise pjesa para me ate pas ku shenohet afati i vlefshmerise,*
- *Shkelqim Rizaj dhe Nazif Cakaj nuk figuron në listpagesat e 3 muajve te fundit.*

II.5. Në datën 15.10.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit nuk plotëson Pika 4.1 Nuk ka paraqitur dokumenta per topograf: Së pari AK duhet ta kualifikojë operatorin ekonomik Shendelli shpk pasi ka përmbushur kërkesën e dhënë në DST pika 4.1 ku duhet të paraqesë sipas AK: 1 inxhinier topograf (eksperiencë pas diplomimit një vit) të shoqëruara me diplomat përkatëse, kontratë pune. Nga ana jonë për përmbushjen e kësaj kërkesë është paraqitur dokumentacioni i kërkuar nga AK dhe është ngarkuar në SPE me emërtimin Shëndelli Stafi P1. Në këtë folder të fq 31-38 gjendet lehtësisht dokumentacioni përkatës për topografin të cilin shoqëria jonë disponon. Znj Engjelushe Sako është e punësuar pranë shoqërisë sonë me pozicionin e punës gjeodede/topografe me një eksperiencë pune shumë herë më të madhe se sa kërkohet në DST. Për Inxhinierin Topograf sipas kërkesave të DST është paraqitur kontratë pune, diploma përkatëse dhe dokumenta shtesë për të vërtetuar punësimin dhe eksperiencën e saj. Pra shoqëria Shendelli shpk ka në stafin e saj të punësuar një topograf sipas kërkesave të AK.*

Sa më sipër skualifikimi për këtë pikë nuk qëndron.

- *Lidhur me arsyen e skualifikimit Pika 4.4 Bojaxhi Edmond Karaj nuk perkon nr i serise se deshmise pjesa para me ate pas ku shenohet afati i vlefshmerise, sqarojmë se AK duhet të kualifikojë operatorin ekonomik Shendelli pasi ka plotësuar kërkesën e dhënë në DST pika 4.4. ku kërkohet:*

4.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pasqyruar në list pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të pakten 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten:

- *Specialist ndërtimi : 1 punonjës*
- *Karpentier : 1 punonjës*
- *Bojaxhi : 4 punonjës*

- *Pllakashtrues : 3 punonjës*
- *Murator : 4 punonjës*
- *Elektricitist : 2 punonjës*

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

AK ka kërkuar nga operatorët ekonomikë të paraqesin dokumentacionin i cili tregon se disponojnë 4 punonjës bojaxhi të cilët të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik ose nga institucione ekuivalente me të. Shoqëria jonë ka paraqitur ndër të tjera dokumentacionin për bojaxhi të Z Edmond Karaj të cilit sipas verifikimeve të bëra nga AK nuk përkon numri i serisë së dëshmisë pjesa para me atë ku shënohet afati i vlefshmërisë . Pretendimi i AK qëndron pjesërisht për sa i përket numrit serial por nuk mund të cilësojë atë dëshmi si të pasaktë dhe të pavlefshëm pasi është një dokument i lëshuar nga një institucion i cili mban përgjegjësi për dokumentacionin që lëshon ku mund të verifikohet vërtetësisht dhe afati i tij dhe mund të kërkohej lehtësisht ta vërtetoni , është i pamjaftueshëm por jo i pasaktë. Por gjithsesi nga ana jonë për përmbushjen e kërkesës për katër punonjës bojaxhi janë ngarkuar në SPE dokumentacion për 5 punonjës bojaxhi ku përveç Z.Edmond Karaj gjithashtu kemi paraqitur si punonjës bojaxhi: Z.Cakaj me emërtimin Shëndelli Bojaxhi N.Cakaj; Z. Faslliaj me emërtimin Shëndelli Bojaxhi F. Faslliaj; Z.Rizaj me emërtimin Shëndelli Bojaxhi Sh.Rizaj; Z.Nuhaj me emërtimin Shëndelli Bojaxhi Xh.Nuhaj, për të cilët sipas kërkesës në DST janë paraqitur kontrata e punës dhe dëshmitë përkatëse të vlefshme për të cilët nuk është konstatuar asnjë gabim për dokumentacionin nga AK. Pra shoqëria jonë ka paraqitur 4 punonjës bojaxhi me dokumentacion të saktë duke plotësuar kërkesën e AK për Bojaxhi 4 punonjës pasi Z.Edmond për të cilin na ka skualifikuar AK është punonjësi bojaxhi shtesë.

Sa më sipër kjo arsye skualifikimi nuk qëndron.

- *Lidhur me arsyen e skualifikimit Shkelqim Rizaj dhe Nazif Cakaj nuk figuron në listëpagesat e 3 muajve të fundit sqarojmë se AK duhet të kualifikojë OE Shëndelli shpk pasi ka përmbushur kërkesën e dhënë në DT pika 4.4 ku ka kërkuar **4.4** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të pakten 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta të jone të pakten:*

Më sipër AK ka kërkuar të paraqiten : Liste pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shendetesore dhe tatim mbi të ardhurat nga punësimi (Formulari numer E-SIG 025/a), për periudhën Maj 2018 – Prill 2019 të konfirmuara sipas formatit elektronik.

Duke ju referuar kësaj kërkesë tre muajt e fundit janë Shkurt 2019, Mars 2019, dhe Prill 2019 dhe punonjësit e përmendur më sipër janë në listëpagesat e shoqërisë sonë

tre muajt e fundit sipas kërkesës në DST. Kjo mund të verifikohet duke kontrolluar listpagesat të cilat shoqëria jonë ka ngarkuar në SPE. Kur vetë AK ka përcaktuar se për cilët muajt të paraqiten listpagesat dhe nga ato nxjerrim tre muajt e fundit pse skualifikon shoqërinë tonë??. Cilat janë sipas AK tre muajt e fundit , cilës datë i referohet pasi në DST kërkon vetëm listpagesat Maj 2018-Prill 2019. Në rast se AK pretendon se tre muajt e fundit nuk janë shkurt 2019, Mars 2019 dhe Prill 2019 atëherë ajo gjendet para një gabimi pasi në DST nuk është shprehur për ndonjë datë ku mund ti referohemi për të llogaritur tre muajt e fundit përveçse te kërkesa ku kërkojnë listpagesat Maj 2018-Prill 2019. Si rrjedhojë AK nuk mund të skualifikojë shoqërinë tonë për një kërkesë të pakërkuar dhe të pashprehur në DST. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimn e saj 887/2016. Si përfundim ashtu si dhe analizuar më sipër sipas kritereve të përcaktuara në DT AK ka kërkuar Listpagesat Maj 2018-Prill 2019 dhe vetëm nga këto listpagesa duhet të nxjerrim tre muajt e fundit pasi në asnjë kërkesë tjetër nuk janë përcaktuar ose përmendur listpagesa të muajve të tjerë ose ndonjë datë të cilës mund ti referohemi për të llogaritur tre muajt e fundit. Pra shoqëria jonë ka përmbushur plotësisht kërkesën e dhënë në DST pasi punonjësit Z.Shëlqim Rizaj dhe Z.Nazif Cakaj janë në listpagesat e shoqërisë dhe AK nuk mund të ngrejë pretendime të pabazuara dhe për më tepër të shtojë kritere pas vlerësimit të ofertave pasi është totalisht në shkelje të LPP. Skualifikimi edhe për këtë pikë nuk qëndron.

Sa më sipër Shendelli shpk duhet të kualifikohet dhe të shpallet fitues.

II.6. Me shkresën nr.2235 prot datë 18.10.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.7. Në datën 24.10.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.2342/2 prot datë 05.11.2019 protokolluar me tonën me nr.1662/2 prot datë 06.11.2019 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Shëndelli” shpk mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Pika 4.4 Bojaxhi Edmond Karaj nuk perkon nr i serise se deshmise pjesa para me ate pas ku shenohet afati i vlefshmerise, - Shkelqim Rizaj dhe Nazif Cakaj nuk figuron në listpagesat e 3 muajve te fundit”, Komsioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3/4.4 ”Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë :

- 4.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pasqyruar në list pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të pakten 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten:
 - Specialist ndërtimi : 1 punonjës
 - Karpentier : 1 punonjës
 - Bojaxhi : 4 punonjës
 - Pllakashtrues : 3 punonjës
 - Murator : 4 punonjes
 - Elektracist : 2 punonjës

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se në përmbushje të kriterit sa më sipër lidhur me disponimin e 4 punonjësve me profesion bojaxhi ankimuesi ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Listpagesat e sigurimeve shoqërore Janar 2019-Gusht 2019
- Kontratë Pune datë 20.01.2018 lidhur ndërmjet Shoqëria Shëndelli shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Festim Faslliaj në cilësinë e punëmarrësit me profesion bojaxhi.
- Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik
- Certifikatë Trajnimi lëshuar nga Aqscert
- Librezë Pune

- Kontratë Pune datë 20.01.2018 lidhur ndërmjet Shoqëria Shëndelli shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Xhevair Nuhaj në cilësinë e punëmarrësit me profesion bojaxhi.
- Certifikatë Trajnimi lëshuar nga Aqscert
- Librezë Pune
- Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik

- Kontratë Pune datë 20.01.2018 lidhur ndërmjet Shoqëria Shëndelli shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Shkelqim Rizaj në cilësinë e punëmarrësit me profesion bojaxhi.
- Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik

- Certifikatë Trajnimi lëshuar nga Aqscert
- Kontratë Pune datë 20.01.2018 lidhur ndërmjet Shoqëria Shëndelli shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe Nazif Cakaj në cilësinë e punëmarrësit me profesion bojaxhi .
- Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik
- Kontratë Pune datë 20.01.2018 lidhur ndërmjet Shoqëria Shëndelli shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe E.Karaj me profesion shofer dhe bojaxhi.
- Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 26 “Kontratat për Punë Publike” pika 8 përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”*

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomikë nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.1.5. KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat

e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në interpretim të kriterit sa më sipër KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të disponojnë 4 punonjës bojaxhi për të cilët kërkohet të paraqiten kontrata e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit sa më sipër KPP konstaton se operatori ekonomik Shendelli shpk ka dorëzuar dokumentacion për 5 bojaxhi të punësuar në stafin e tij për të cilët ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriterin e kualifikimit kontrata pune e dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, por rezulton që dy nga punonjësit konkretisht Shkelqim Rizaj dhe Nazif Cakaj nuk rezultojnë në listagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tre muajt e fundit referuar datës së zhvillimit të tenderit që i përkon periudhës Qershor 2019-Gusht 2019 dokumentacion të cilin ankimesi e ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike. KPP gjykon se ankimesi gabon në referencën e tij tek kriteri tjetër i kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi sepse ai nuk i është përmbajtur kriterit konkret i cili ka kërkuar që për tre muajt e fundit duhet të rezultojnë të punësuar teknikët e sipërcituar.

Pra në interpretim të kriterit sa më sipër KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka kërkuar që punonjësit e sipërcituar duhet të rezultojnë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit referuar datës së zhvillimit të tenderit. Në këto kushte KPP gjykon se ankimesi nuk plotëson kriterin lidhur me 4 punonjës me profesion bojaxhi pasi dy nga punonjësit për të cilët është paraqitur dokumentacion nuk rezultojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.6. KPP gjykon se mosplotësimi i kriterëve të kualifikimit në mënyrën e kërkuar përbën shkak për skualifikim në përputhje me nenin 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 e ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Në këto kushte, referuar arsyetimit sa më sipër, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "Shendelli" sh.p.k. në rastin konkret nuk është i plotë dhe nuk është në përputhje me kriterin e kualifikimit të përcaktuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.7. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“ [...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Shendelli” shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “Shendelli” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë dhe operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Shendelli” sh.p.k për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-32210-07-31-2019, me objekt “*Rikonstruksion i Zyrave Ekzistuese*”, me fond limit 14'204'935 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 30.09.2019 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime sha Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1662 Protokolli; Datë 24.10.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha